



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 53/09

Prishtinë, më 15.06.2009, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Besa Gaxherri, Müfera Şinik, Haki Shatri, Riza Smaka, dhe Shkumbin Demaliaj.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Naser Osmani, Hajdin Abazi.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Vilson Ukaj, Dashurie Canolli, Fatmire Vojvoda (praktikante), Gazmend Avdyli (praktikant).**

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: **Lars Lage Olofsson Auditor i Përgjithshëm, Fatmir Uka drejtor i administratës nga ZAP, Agim Krasniqi - Drejtor i Buxhetit pranë MEF-it, Bashkim Ibishi nga ZK, Naim Avdiu zv.Drejtor menaxhues i AKP-së, Avni Jashari drejtor i buxheti dhe financave të AKP, Ismet Krasniqi - Sekretar i Kuvendit, Teki Shala nga NDI, monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, ICO, KDI.**

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara dt. 25.05.2009 dhe 1.06.2009;**
- 3. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr-1251/2 dt. 15.05.2009 për lejimin e transferimit të mjeteve nga Buxheti i Zyrës për Çështje të Komuniteteve në Komunën e Kamenicës;
I ftuar : **Bashkim Ibishi, Zëvendës Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve;****
- 4. Shqyrtimi i kërkesës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm nr. 159 dt. 25.05.2009 lidhur me rishikimin Gjashtëmujor të Buxhetit për vitin 2009
I ftuar : **Lars Lage Olofsson, Auditor i Përgjithshëm;****
- 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjensionit Kosovar të Privatizimit për periudhën e përfunduar 31 dhjetor 2008**

I ftuar : Dino Asanaj, Kryetar i Bordit të Drejtorëve;

6. **Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2010 në bazë të qarkores së parë të MEF-it 2010/01;**
7. **Shqyrtimi i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës L-03/136 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;**
8. **Shqyrtimi i Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;**
9. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara dt. 25.05.2009 dhe 1.06.2009

Kosara Nikolić, bëri vërejtje në procesverbalin e dt. 25.05.2009, në diskutimi e saj për pikën e 58 të rendit të ditës, kërkoi që vërejtjet e saja të përfshihen në atë procesverbal.

Kryesuesi, konstatoi se procesverbalet nga mbledhjet e kaluara dt. 25.05.2009 dhe 1.06.2009, miratohet me vërejtjet e znj. Kosara Nikolić.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr-1251/2 dt. 15.05.2009 për lejimin e transferimit të mjeteve nga Buxheti i Zyrës për Çështje të Komuniteteve në Komunën e Kamenicës

Kryesuesi, theksoi se kërkesa për transferin e mjeteve nuk është e kompletuar. Nuk është përfillur procedura që kërkesa të dorëzohet në Departamentin e buxhetit në kuadër të MEF-it. Përveç kësaj duke pasur parasysh kohën e rishikimit të buxhetit dhe pamundësinë që e njëjta të procedohet në Kuvend në këtë periudhë, sugjeroi që Zyra për Komunitet të kompletoi kërkesën dhe të dërgojë në MEF, që ajo të mund të përfshihet në buxhetin e rishikuar.

Besa Gaxherri, pajtohem me konstatimet e hartimi dhe procedimi i kërkesës është i papranueshëm dhe duhet të ndryshojë kjo praktikë e komunikimit zyrtar. Megjithatë për të mos humbur donacionet, do të ishte mirë që Komisioni të bënte një rekomandim se me rastin e rishikimit të buxhetit të lejohet ky transfer.

Safete Hadërgjonaj, theksoi se është e papranueshme se si procedohen kërkesat në Kuvend. Me rastin e hartimit të kërkesave dhe procedimit të tyre, të përfillet Ligji për menaxhimin e financave publike, i cili rregullon çështjen e transfereve të mjeteve, prej një kodi buxhetor në tjetrin ndërmjet organizatave buxhetore. Të ndërpritet mënyra e tillë e procedimit të kërkesave.

Bashkim Ibishi, theksoi se kërkesa e ka arsyeshmërin e vet, por ndihet keq që nuk është e kompletuar na aspektin financiar. Duke pasur parasysh kushtin që ka vënë donatori i jashtëm për bashkëfinancim të projektit, shfaqti brengjen se mundet të humbet ky donacion. Po ashtu nëse përfillet procedura e futjes së buxhetin e rishikuar, do të mund të ishte vonë, për shkak se tani është faza e fundit e miratimit të rishikimit të buxhetit në Qeveri.

Agim Krasniqi, duke u ndërlidhur, u pajtua me konstatimet se kërkesa nuk është e kompletuar, nuk po jepen sqarime për transfer, përveç arsyeshmërisë së saj. Të gjitha kërkesat duhet drejtuar MEF-it, i cila në bazë të ligjit përgatit rekomandimin, se a duhet të marrë vendim Qeveria apo Kuvendi. Duke pasur parash faktin se rishikimi i buxhetit është ndalur për shkak të kërkesave të FMN-së, Komisioni për Buxhet dhe Financa mund të bëjë një rekomandim që kërkesa të adresohet në MEF, për mundësinë e përfshirjes në rishikimin e buxhetit.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni vlerësoi se kërkesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr-1251/2 dt. 15.05.2009 për lejimin e transferimit të mjeteve nga Buxheti i Zyrës për Çështje të Komuniteteve në Komunën e Kamenicës, nuk është e kompletuar dhe nuk është në përputhje me Ligjin nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin nr.03/L-105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për transferin e mjeteve prej një organizate buxhetore në organizatën tjetër buxhetore.
- II. I rekomandon Zyrës për Çështje të Komunitetet që të njëjtën kërkesë ta plotësojë dhe ta dërgojë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave që të mund të përfshihet në rishikimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për gjashtëmuorin e vitit 2009.

4. Shqyrtimi i kërkesës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm nr. 159 dt. 25.05.2009 lidhur me rishikimin Gjashtëmuor të Buxhetit për vitin 2009

Kryesuesi, theksoi se kërkesa e ZAP-së është e arsyeshme, por duke pasur parasysh pamundësinë e ndryshimit të kufijve të përgjithshme buxhetor, të shikohet mundësia e plotësimit brenda buxhetit të ZAP-së. Prandaj sugjeroi e njëjta të drejtohet në MEF, e cila të shikojë mundësinë e plotësimit të saj, duke respektuar kufijtë e buxhetit 2009.

Lars Lage Olofsson, theksoi se me qëllim të respektimit të Kushtetutës dhe Ligjit, të cilat i garantojnë ZAP-së pavarësi dhe funksionalitet në punë, për të realizuar këto objektiva kërkohen mjete shtesë në këtë fazë. Jemi duke punuar që t'iu dërgojmë 26 raporte të auditimit si dhe raportin vjetor. Këto raporte do të mund t'iu shërbejnë si inpute me rastin e shqyrtimit të buxhetit. Ndërsa nga muaji shtator do të fillojmë me auditimet për vitin 2009. Për të arritur objektiva dhe që ky institucion të shëndrrohet një organizatë profesionale dhe efikase, kërkohen mjete shtesë buxhetore si dhe staf i ri, si mbajtja e stafit ekzistues. Ndërsa arsyeja e kërkesës së mjeteve shtesë për konsulentë, ka të bëjë me faktin se në bazë të kërkesës së Qeverisë për të parë funksionimin e Sistemit të Thesarit, kemi menduar ti kontraktojmë auditorët për të bërë auditimin e të gjitha komunave 2008, përjashtimisht Komunën Prishtinës, në të cilën është kryer auditimi.

Armend Zemaj, duke u ndërlidhur me kërkesën e auditorit të përgjithshëm, theksoi se ZAP-ja është një institucion i pavarur dhe profesional, vetëm se duhet përforcuar punën dhe performancën e saj. Sa i përket mënyrës së plotësimit të buxhetit shtesë, duke pasur parasysh faktin se veproni në objekt privat me qira të lartë, sugjeroi që ti drejtohen Qeverisë për vendosjen në objekte publike, dhe nga ato mjete që janë paraparë për qira, të shikohet mundësia e plotësimit të kërkesave tuaja.

Myrvete Pantina, vlerësoi arsyeshmërinë e kërkesës. Por megjithatë kërkoi sqarim, pse ekziston një dallim me kërkesën e parë, të paraqitur në fazën e miratimit të buxhetit.

Riza Smaka, konsideroi se për mjetet e parapa për kontraktimin e auditorëve të jashtëm, nuk janë dhënë sqarime, se sa auditorë do kontraktohen. Gjithashtu vlerësoi si çështje jo të mire përcaktimin e pagave të ndryshme nga organizatat buxhetore, siq po ndodh edhe me këtë kërkesë, nga i cili kemi favorizime dhe disfavorizime dhe shfaq shpresën se kjo çështje të rregullohet me Ligjin për paga.

Shkumbin Demaliaj, duke pasur parasysh nevojat e kësaj zyre të paraqitura në këtë kërkesë, pyeti pse të njëjtat nuk janë paraqitur me rastin e miratimit të buxhetit. Ndërsa pyetjen e dytë kërkoi sqarime për gabimet në llogaritje të buxhetit të kësaj zyre në miratimin e buxhetit.

Besa Gaxherri, theksoi se rëndësia për funksionimin e këtij institucioni është e madhe. Shfaq shpresën që auditorit i përgjithshëm do të merret seriozisht në ngritjen e kapaciteti dhe profesionalizimit të këtij institucioni, që të arsyetohen pagat, që nuk janë edhe aq të ulta për standardin tonë. Në këtë drejtim mbështeti kërkesën e ZAP-së. Duke u ndërlidhur me kërkesën e Qeverisë për auditimin e komunave, theksoi se ne kërkojmë që të auditohen edhe Qeveria, sidomos zërat buxhetor të investimeve kapitale.

Agim Krasniqi, theksoi se deri më tani kërkesa buxhetore për mjete shtesë kanë arritur shifrat të larta. Janë disa kërkesa që nuk mund të refuzohen, e që kanë të bëjnë me anëtarësimin e Kosovës në institucionet financiare ndërkombëtare. Sa i përket çështjes së pagave duhet që të gjithë shërbyesit civil të paguhen njësoj. Pagat e parapara për agjencionet e pavarura, në këtë rast edhe ZAP-së, janë destimulues për pagat e shërbyesit tjerë civil. Qeveria do të shqyrtojë të gjitha kërkesat dhe do të përgjigjet në bazë të kapaciteteve buxhetore dhe politikës së FMN-së.

Kryesuesi, me rastin e parashtrimit të kërkesës në fazën e miratimit të buxhetit është bërë një llogaritje e gabuar, pyeti ku qendrojnë problemet. Sa i përket koeficienteve për shërbyesit civil, ato duhet të jenë unike për të gjithë, shoferi është shofer apo asistent është asistent dhe klasifikohet si shërbyes civil, kudo që të punojë. Në vazhdim theksoi se komisioni do të kërkojë një listë nga MEF-i, të të gjitha kërkesave buxhetore, që kanë të bëjnë me rishikimin e buxhetit për të parë mundësinë buxhetore të plotësimit të tyre.

Fatmir Uka, theksoi se ka ndodhur një gabim në përlllogaritje, por jemi brenda shumave që janë aprovuar në Kuvend. Dep. e administratës në fazën e rishikimit të buxhetit 2008 ka përgatit buxhetin për gjashtë muaj në vijim, dhe të njëjta shuma i ka paraqitur edhe në buxhetin e vitit 2009. Për gabimet në llogaritje i kemi njoftuar zyrtarë MEF-it, të cilët na kanë thënë se me rishikim do të rregullohet kjo çështje. Ndërsa sa i përket pikës 8 të kërkesës, ka të bëjë me faktin se Thesari është në proces të bartjes së kompetencave në organizatave buxhetore, të cilat duhet çertifikuar, për të bërë këtë çertifikim është kërkuar një raport i auditimit për këto organizatat.

Safete Hadërgjonaj, theksoi se përkrah punën dhe veprimin e pavarur të kësaj zyre, por nuk do të duhej dalur jashtë sistemit. Nga kërkesa shifet se koordinatori i transporti ka rrogën 351 €, që dallon nga pjesa tjetër e shërbyesve civil. Prandaj duhet bërë reduktime në këtë kërkesë. Të merren parasysh edhe rekomandime e FMN-së për mosshtimin e numrit të punëtorëve. ZAP-ja deri më tani nuk ka treguar performancë të mirë, për të arsyetuar shumat e kërkuara. Është dashur të jemi të njoftuar me planin e veprimit të kësaj zyre, që të arsyetohen mjetet e kërkuara.

Fatmir Uka, plani i veprimit i nënshkruar nga Kryeministri parashe rritjen e stafit të ZAP për pesë vite 100%, deri në plotësimin e numrit adekuat prej 60 auditorëve. Për këtë i raportojmë edhe Komisionit Evropian.

Agim Krasniqi, çdo plan dhe strategji do të duhej bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, dhe çdo provim planit në kundërshtim me këtë, e qet në lajthitje aprovuesin e saj.

Besa Gaxherri, pasi që marrëveshje është nënshkruar nga Kryeministri, është obligim i ZAP-së që të implementoj.

Kryesuesi, pasi që Qeveria është organ ekzekutiv dhe menaxhon me burimet financiare, Komisioni i rekomandon MEF-it, të trajtojë këtë kërkesë në bazë të burimeve ekzistuese buxhetore.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni vlerësoi të arsyeshme kërkesën buxhetore të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm nr.159, dt.25.05.2009 lidhur me rishikimin Gjashtëmujor të Buxhetit për vitin 2009, dhe i rekomandon Ministrisë për Ekonomi dhe Financa që në fazën e rishikimit gjashtëmujor të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009, të shikojë mundësinë e përfshirjes e kësaj kërkesë në buxhetin e rishikuar, brenda kufijve të përgjithshëm buxhetor.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencionit Kosovar të Privatizimit për periudhën e përfunduar 31 dhjetor 2008

Kryesuesi, vlerësoi raportin ndër më të kompletuarit, si në paraqitjen e tabelave, analizave dhe specifikimeve. Për më tepër rreth raportit, ia dha fjalën përfaqësueseve të AKP-së.

Avni Jashari, theksoi pasqyrat financiare janë përgatitur konform standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik dhe raportimit financiar sipas kontabilitetit të bazuara në paranë e gatshme. Në raport është paraqitur një përmbledhje e aktiviteteve të AKP-së, nga themelimi deri në fund të vitit 2008. Aktivitetet e AKP-së financohen nga Buxheti i Kosovës dhe fondeve të donatorëve. Deri më 31 dhjetor, AKP-ja ka pasur 866 llogari të mirëbesimit. Janë paraqitur llogaritë bankare të procesit të privatizimit dhe likuidimit. Shuma e mjeteve në BQK deri në fund të vitit 2008, ka qenë 403.313.000€, në Bankën Pro Credit 231.000€, janë mjetet që i mbajmë për ndërmarrjet e reja. Nuk kemi asnjë avancë të pambyllura, dhe asnjë hua ndaj palëve të treta. Kemi paguar disa obligime të AKP-së, që lidhen me procesin e privatizimit rreth 30.000€.

Shkumbin Demaliaj, pyeti sa është shuma në përqindje e mjeteve të 20% që u takojnë punëtorëve nga privatizimi i pronave shoqërore. Sa i përket pronave të privatizuara që janë kontestuar, u interesua të dinte se sa prej pronarëve legjitim kanë mundur të realizojnë të drejtën e tyre në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, dhe a iu janë kthyer pronat atyre.

Myrvete Pantina, kërkoi të dijë se ka filluar të zbatohet memorandum i mirëkuptimit i nënshkruar në mes AKP-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Po ashtu kërkoi sqarime për diferencën e paraqitur në mes zotimeve të pashpenzuara nga ato të alokuara që janë paraqitur në kategorinë mallra dhe shërbime. Të drejtat legjitime të punëtorëve nga të ardhurat e privatizimit janë mbi 77 mili €, ndërsa janë transferuar BSPK-së mbi 18 mili €, kërkoi sqarime për një diferencë të kësaj.

Riza Smaka, në bazë të informacioneve ka shumë kërkesa të kontestuara, dhe Dhoma e Veçantë nuk funksionon si duhet në këtë drejtim. Prandaj do të ishte mirë të inicioni ndryshimin e statutit të saj, që të krijohet si Kolegj i Veçantë. Lidhur me këtë, pyeti sa janë shumat në total nga kërkesat e kontestuara.

Safete Hadërgjonaj, vlerësoi raportin mirë të përgatitur, në veçanti i ka bërë përshtypje për të mirë pasqyrimi i detalizuara i të dhënave. Pyeti se qfarë lëvizjesh keni bërë fondi i AKP-së, të kthehet dhe mjetet të investohen në Kosovë.

Naim Avdiu, sa i përket pyetjes për shpërndarjen e 20%, nga 77 milion € sa u takon punëtorëve, 18 mili€ iu janë shpërndarë punëtorëve (23.7%). Ndërsa numri i kërkesave kontestuese të pronave janë mbi 35.000 të natyrave të ndryshme. Ndërsa Oda e Veçantë është në proces të transformimit, memorandum i bashkëpunimit me Ministrin e Punëve të Brendshme, për kontrollin e valëve dhe blerësve të privatizimit lidhur me prejardhjen e pasurisë së tyre, është në funksion e sipër. Ndërsa për mjete e AKP-së, kemi bërë kërkesë BQK-së që të kthehen në Kosovë. Në bazë të ligjit, AKP-ja është i vetmi institucion që mund ti investoj këto mjete. Ne kemi bërë vetëm depozitimin e mjeteve dhe jo investimin e tyre.

Avni Jashari, arsyeja e zotimeve të pashpenzuara , për shkak të numrit të vogël të të punësuarve në fillim të punës së AKP-së. Ndërsa mjetet e pashpenzuara për auditim, dhe mjetet tjera të pashpenzuara që janë pasqyruara në raport janë bartura në vitin 2009. Nuk kemi detyrime kontingjente të AKP-së që mund të kenë ndikim në Buxhetin e Kosovës.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Raporti vjetor financiar i Agjencionit Kosovar të Privatizimit për periudhën e përfunduar 31 dhjetor 2008 i plotëson standartet ligjore të kontabilitetit për raportim.
- II. I rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që në seancën plenare të miratojë Raportin vjetor financiar të Agjencionit Kosovar të Privatizimit për periudhën e përfunduar 31 dhjetor 2008.
- III. Me qëllim të menaxhimit më të mirë të mjeteve financiare të siguruara nga privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Komisioni, i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës të iniciojë procedurën e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit nr.03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

6. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2010 në bazë të qarkores së parë të MEF-it 2010/01

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të përkrahin kërkesën buxhetore të Kuvendit dhe të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit, që ti rekomandojë MEF-it që të njëjtën ta fus në kornizat e buxhetit 2010.

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandon Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës të miratojë kërkesën buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2010.
- II. Komisioni kërkon nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës t'i rekomandojë Ministrisë për Ekonomi dhe Financa që të njëjtën ta përfshijë në linjat buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2010.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës L-03/136 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për Projektligji dhe amendament e komisionit funksional lidhur me mundësin e implikimeve financiare të tyre.

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës L-03/136 dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

8. Shqyrtimi i Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për Projektligji dhe amendament e komisionit funksional lidhur me mundësin e implikimeve financiare të tyre.

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara

Mbledhja përfundoi në ora 15:20

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI